Shërbimet fushën e funksioneve dhe kompetencave deleguara

Funksionet dhe kompetencat e deleguara janë të detyrueshme ose jo të detyrueshme.

Funksione dhe kompetenca të detyrueshme janë ato të përcaktuara me ligj. Institucionet qendrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë bashkinë të kryejnë funksione të caktuara, duke përcaktuar, kur është e nevojshme, procedurat e kryerjes e të kontrollit për zbatimin e tyre.

Institucionet qendrore mund të autorizojnë bashkinë të ushtrojnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar.

Bashkisë mund t'i delegohen funksione dhe kompetenca të tjera jo të detyrueshme, mbi bazën e një marrëveshjeje midis njësisë së vetëqeverisjes ven dore përkatëse dhe institucionit qendror përgjegjës me ligj për këtë funksion ose kompetencë.

Në çdo rast qeverisja qendrore u garanton njësive të vetëqeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Bashkia me nismën e saj, mund të përdorë burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve e të kompetencave të deleguara, me synim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit në interes të bashkësisë.